



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 05

Prishtinë, më 4 prill 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Arsim Bajram, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli dhe Jasmina Živković.

Munguan: Mufera Šinik dhe Behar Selimi

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Isuf Zejna – KDI, Lumnije Murati – ZPRK, Floriana Shala – OSBE, Artan Canhasi – EULEX, Vlora Marmullakaj – EULEX, Fixhrije Dragaj dhe Alban Krasniqi – praktikant.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23. 3. 2011;
3. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit, nr. 04-P-012/k, përkitazi me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për Ligjin për të drejtat dhe për përgjegjësitë e deputetit;
4. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për Legjislacion për vitin 2011;
5. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit të Pavarur për Media;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, propozoi që pikë e rendit të ditës të jetë edhe shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë lidhur me kërkesën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore, sepse kishte mbetur nga mbledhja e kaluar.

Rendi i ditës u miratua me plotësim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23. 3. 2011

Kryetari, konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 23. 3. 2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit, nr. 04-P-012/k, përkitazi me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për Ligjin për të drejtat dhe për përgjegjësitë e deputetit

Kryetari - I njoftoi të pranishmit për Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, që e ngarkon Komisionin për Legjislacion ta shqyrtojë kërkesën e gjykatës Kushtetuese, që e ka vendosur masën e përkohshme për disa nene në Ligjin për të drejtat dhe për përgjegjësitë e deputetit. Propozoi të formohet një grup i punës, që do ta hartonte një përgjigje për Gjykatën Kushtetuese. Para se t'i përcillet përgjigjja Gjykatës Kushtetuese ajo, gjithsesi, të shqyrtohet edhe një herë në Komision.

Ibrahim Makolli - U pajtua me parafolësin që të formohet një grup pune, që të punojë në mënyrë më të hollësishme në lidhje me këtë çështje, në mënyrë që t'i jepet një përgjigje Gjykatës Kushtetuese.

Armend Zemaj - Theksoj se nuk ka kurrfarë baze ligjore dhe as arsyeshmëri që ka ardhur deri te ky vendim, sepse e kuptojmë dhe nuk ka nevojë të na tregojë askush, as Gjykata Kushtetuese, se rendi kushtetues bazohet në parimet e demokracisë, të barazisë dhe të mosdiskriminimit. Sa u përket privilegjeve të deputetëve tha se janë shkurtuar në masën më të madhe, prej 99%. Nëse dëshiron ndokush të bëjë krahasime midis neneve të ligjit, që ka kaluar në Legjislaturën e dytë dhe në Legjislaturën e tretë, shkurtimet bëhen në masën prej 99%.

Albulena Haxhiu - Ndau mendimin me parafolësin duke thënë se këto nene janë në kundërshtim me çfarëdo parimi për barazi sociale. Ajo mendon se këto nene duhet të rishikohen edhe një herë, sepse aspak nuk përputhen me standardin jetësorë dhe me gjendjen socio-ekonomike në vend. Nuk është normale që një deputet të ketë pension aq të lartë, ndërsa një person, që ka kontribuar 40 vjet në çfarëdo profesion qoftë, të marrë pension aq të ulët. I mbështes të gjitha arsyetimet e Avokatit të Popullit. Gjithashtu ishte e mendimit se duhet të formohet grupi punës.

Arsim Bajrami - Duhet ta kuptojmë këtë si çështje procedurale. Gjykata Kushtetuese ka kërkuar përgjigje dhe ne duhet të përgjigjemi, sepse kështu e do procedura.

Ardian Gjini - U pajtua me parafolësin që si komision t'i dërgohet përgjigje Gjykatës Kushtetuese.

Haki Demolli - U pajtua me parafolësit se duhet t'i dërgohet përgjigje Gjykatës Kushtetuese dhe se duhet të shikohet ligji vetëm në aspektin e kushtetutshmërisë.

Kryetari - Propozoi që në grup të punës të jenë: Haki Demolli, kryesues i grupit të punës, Arsim Bajrami dhe Albulena Haxhiu.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni për Legjislacion, lidhur me këtë çështje, e nxori këtë*

PËRFUNDIM

Formohet Grupi i punës për hartimin e përgjigjes në kërkesën e Gjykatës Kushtetuese për Ligjin për të drejtat dhe për përgjegjësitë e deputeti, në këtë përbërje:

*Haki Demolli – kryesues,
Arsim Bajrami – anëtar dhe
Albulena Haxhiu - anëtare.*

4. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për Legjislacion për vitin 2011

Komisioni e shqyrtoi planin e punës së Komisionit për Legjislacion për vitin 2011 dhe pasi nuk kishte vërejtje e nxori këtë

PËRFUNDIM

Komisioni për Legjislacion e miratoi planin e punës për vitin 2011.

5. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit të Pavarur për Media

Kryetari - I njoftoi të pranishmit për shkresën e Komisionit të Pavarur për Media, për pjesëmarrjen e një anëtari të Komisionit për Legjislacion, në mbledhjet e rregullta të KPM-së, lidhur me zhvillimin e strategjisë për digjitalizimin e medias në Kosovë.

Komisioni lidhur me këtë e nxori këtë

PËRFUNDIM

Komisioni për Legjislacioni vendosi që pjesëmarrës në grupet e punës që i organizon KPM-ja lidhur me zhvillimin e strategjisë për digjitalizimin e medias në Kosovë, të jetë Arben Gashi – kryetar i Komisionit për Legjislacion.

6. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë lidhur me kërkesën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore

Kryetari - I njoftoi të pranishmit se në mbledhjen e kaluar ishte vendosur të kërkohej plotësimi i dosjes për Adem Vokshin, i propozuar nga Gjykata Supreme e Kosovës për anëtar në Komisionin për Kërkesa Pronësore. Lidhur me këtë kërkoi nga anëtarët e Komisionit t'i paraqesin vërejtjet që mund t'i kenë rreth dokumentacionit të ofruar.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni për Legjislacion, lidhur me këtë çështje, e nxori këtë:*

Rekomandim

Të emërohet Adem Vokshi anëtar i Komisionin për Kërkesa Pronësore.

7. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk u ngritën çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Kryetar i Komisionit

Arben Gashi